REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 229/17
Datë/Datum. 18.07.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Agjencia Kadastrale e Kosoves**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **60100-17-1000-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **RINDËRTIMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE NË 15 ZONA KADASTRALE, Komunat: Drenas, Skënderaj, Kamenicë dhe Viti**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Lorenco & CO dhe Urban Metropol SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Dritan Hoxha, P.117, Tirana- Shqipëri, Rr. Shaban Polluzha, Nr.34, Prishtinë, Kosovë
(Adresa)

Shqiperi-Kosove
(Vendi)

1000
(Kodi postar)

+377[redacted]
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Lorenc Zani
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[redacted]@gmail.com
(Adresa elektronike)

18.07.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR Lorenco & CO. Dega në Kosovë PRISHTINË

SHPK "Urban Metropol" PRISHTINË

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

- Njoftimi I kontrates: 27.03.2017,
- Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje 12.04.2017, ora 14:30
- Njoftimi për anulimin e aktivitetit te prokurimit 03.07.2017,

7. **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Kadastrale e Kosovës) ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si në vijim:

- **Shkelje e Nenit 58 të LPP-së, Hapja e Tenderëve;**
- **Shkelje e Nenit 56 të LPP-së, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;**
- **Shkelje e Nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;**

8. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Detajet dhe Argumentet lidhur me shkeljet e **Nenit 58 të LPP-së, Hapja e Tenderëve:**

Gjatë hapjes se tenderit konsorciumi "Counsulting Engineering & GeoMap", pikërisht perfaqesuesi i konsorciumit Florent Emini ka bërë presion ndaj perfaqësueses së prokurorimit ne përshkrimin e vërejtjes në fjal, duke u munduar ta binde atë dhe fizikisht ka nderhy ne kompjuterin e personit zyrtar (në mënyr mashtruese) ta shkruaj vërejtjen, gjë që insistimi dhe arritja e qellimit të tij në një vërejtje të pa bazuar është e paligjshme, tendencioze dhe në dëm të konsorciumit tonë.kurse ne gjat hapjes kemi kundershtu dhe informu qe kjo verejtje nuk mund të bëhet kjo sepse eshte e pabaz, megjithate AK e ka bërë këtë verejtje.

Detajet dhe Argumentet lidhur me shkeljet e **Nenit 56 të LPP-së, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;**

Dispozitat e ligjit mbi prokurimin publik e obligojn autoritetin kontraktues që gjitha kontratat publike do të jepen s'pari përmes vlerësimit te tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Gjithashtu, autoriteti kontraktues duhet të ketë të njohur mirë që Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

(i) Eliminimi i Konzorciumit "Lorenco & CO dhe Urban Metropol SH.P.K." dhe Vendimet kontradiktore të nxjerruna nga autoriteti kontraktues lënë të kuptohet që me rastin e vlerëmit të tenderëve nuk janë respektuar kërkesat e pjesmarrjes, te përgaditjes së dosjes së tenderit si dhe ato te kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, respektivisht gjatë procesit vlerësues mbase qëllimisht janë përdorur elemente të reja në kundërshtim me kërkesat dhe dëshmitë e parashtruara me DT.

Detajet dhe Argumentet lidhur me shkeljet e **Nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve:**

Duke u bazuar ne dosjen e tenderit Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale në 15 zona kadastrale, komunat: Drenas, Skënderaj, Kamenicë dhe Viti, me nr.prokurorimit: **60100-17-1000-2-1-1**, e shkarkuar në webfaqen zyrtare të prokurorimit publik të Kosovës "https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/" në nenin **22 Vulosja dhe Shënimi i Tenderit** Agjencia Kadastrale e Kosoves ka paraqitur, Si dhe është paraqitur lidhshmeria e ketij neni me nenin 19: